



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 29.12.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të 29.12.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik " **INFINITT** " SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me " **Ri tender - Furnizim me pajisje bujqësisë, teknologjisë ushqimore, hotelerisë në shkollën profesionale Kadri Kusari**", Nr. i prokurimit- 632-23-12909-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-152-121, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " **INFINITT**" SH.P.K., e dt.20.12.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " **Ri tender - Furnizim me pajisje bujqësisë, teknologjisë ushqimore, hotelerisë në shkollën profesionale Kadri Kusari**", Nr. i prokurimit- 632-23-12909-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-152-121, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 27.12.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 27.12.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.29.12.2023, Operatori Ekonomik " **INFINITT**" SH.P.K., ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: " **Ri tender - Furnizim me pajisje bujqësisë, teknologjisë ushqimore, hotelerisë në shkollën profesionale Kadri Kusari**", Nr. i prokurimit- 632-23-12909-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-152-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 29.12.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:


Pretendimet e juaja nuk qëndrojnë, sepse ju keni sjell sqarime, por jo për pozicionin nr.5, për të cilin edhe ju janë kërkuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Faton Gutaj


Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës